L I G J
Nr.8477, datë 22.4.1999

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7819, DATË 27.4.1994 "PËR PRONËSINË INDUSTRIALE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7819, datë 27.4.1994 "Për pronësinë industriale", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 81, paragrafi i katërt ndryshohet si vijon:

"Në qoftë se kërkesa plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 78 të këtij ligji, Drejtoria e Patentave dhe Markave njofton me shkrim paraqitësin e kërkesës për pranimin për shqyrtim të kërkesës."

Neni 2

Në nenin 82 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

-Paragrafi i tretë ndryshohet si vijon:

"Brenda një periudhe 5-mujore pas pranimit për shqyrtim të kërkesës, Drejtoria e Patentave dhe Markave, në përputhje me rezultatet e shqyrtimit miraton vendimin për regjistrimin e markës ose për refuzimin e regjistrimit dhe e publikon atë. Paraqitësi i kërkesës lajmërohet me shkrim për vendimin dhe, nëse vendimi është pozitiv, njoftohet për të paguar tarifën e regjistrimit dhe të publikimit të markës."

Neni 3

Pas paragrafit të pestë shtohet paragrafi i gjashtë, me këtë përmbajtje:

"Në qoftë se paraqitësi i kërkesës bën pagesën e regjistrimit, menjëherë pas miratimit, në favor të vendimit që rezulton nga shqyrtimi, Drejtoria e Patentave dhe Markave regjistron markën në "Regjistrin e Markave" dhe publikon markën në gazetën e markave, gjithashtu i lëshon çertifikatën e regjistrimit të markës paraqitësit të kërkesës."

Neni 4

Pas nenit 82 shtohet neni 82/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 82/1

Kundërshtimi i regjistrimit të markës

1. Kundërshtimi, në formë të shkruar, depozitohet në bordin e apelimit.

2. Bordi i apelimit njofton paraqitësin e kërkesës për kundërshtimin dhe përcakton periudhën për dhënien e përgjigjes.

3. Në përputhje me rezultatet e shqyrtimit të kundërshtimit, bordi i apelimit miraton vendimin në favor të kundërshtimit, në tërësi ose pjesërisht, ose e refuzon atë."

Neni 5

Pas nenit 82/1 shtohet neni 82/2, me këtë përmbajtje:

"Neni 82/2

Shqyrtimi i kundërshtimit

1. Kundërshtimi, që parashtrohet në përputhje me nenin 73, paragrafi i tretë dhe i katërt dhe nenin 75, paragrafi i dytë pikat a, b, c të këtij ligji, shqyrtohet nga bordi i apelimit.

2. Kundërshtimi shqyrtohet brenda 3 muajve nga data e marrjes së përgjigjes së paraqitësit të kërkesës.

3. Apeluesi ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij ftohen të marrin pjesë në procedurën e bordit të apelimit. Kur kundërshtimet janë shqyrtuar, të dyja palët kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurë, të parashtrojnë materialet e nevojshme dhe të sigurojnë shpjegimet gojore. Vendimi merret në mungesë të palëve të interesuara, u njoftohet atyre me shkrim brenda një muaji nga data e marrjes së tij.

4. Vendimi i bordit të apelimit, për pajtueshmërinë e kërkesave të nenit 73, paragrafi i tretë dhe i katërt, të këtij ligji, do të jetë i formës së prerë. Paraqitësi i kërkesës mund të apelojë kundër vendimeve të tjera të bordit të apelimit, në gjykatë, brenda 6 muajve nga data e vendimit."

Neni 6

Pas nenit 82/2 shtohet neni 82/3 me këtë përmbajtje:

"Neni 82/3

Ndryshimet në "Regjistrin e markave"

Pronari i markës njofton Drejtorinë e Patentave dhe Markave për ndryshimet e mëposhtme:

1.ndryshimin e emrit ose të adresës së pronarit;

2.ndryshimin e emrit ose të adresës së përfaqësuesit;

3.kufizimin e listës së mallrave ose të shërbimeve;

4.ndryshimin, në tërësi ose pjesërisht, në pronësinë e regjistrimit.

Drejtoria e Patentave dhe Markave, kundrejt pagesës së tarifës dhe kundrejt dorëzimit të çdo evidence që mund të kërkohet, regjistron ndryshimet në "Regjistrin e markave", si dhe në certifikatën e regjistrimit."

Neni 7

Në nenin 83, pas paragrafit të pestë, shtohet paragrafi i gjashtë, me këtë përmbajtje:

"Mbajtësi i markës, që mendohet të jetë i mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, edhe nëse nuk është i regjistruar sipas kritereve të përcaktuara në këtë ligj, ka të drejtë të privojë palët e

treta nga përdorimi në tregti, pa autorizimin e tij, të çdo shenje e cila ka të bëjë me një riprodhim, imitim ose përkthim të markës. Koncepti i markës së mirënjohur përcaktohet nga Drejtoria e Patentave dhe Markave."

Neni 8

Në nenin 86, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"Regjistrimi i markës tregtare dhe i shërbimit bëhet për 10 vjet nga data e depozitimit. Në qoftë se regjistrimi nuk përtërihet në kohën e duhur, Drejtoria e Patentave dhe Markave, në përputhje me kërkesën e pronarit dhe të pagesës së tarifës shtesë nga ai, përcakton një periudhë 6-mujore shtesë për ripërtëritjen e regjistrimit."

Neni 9

Në kapitullin XXIII, "Kontratat e licencës", titulli ndryshohet dhe zëvendësohet me fjalët "Transferimi dhe licencimi i markës".

Neni 10

Pas nenit 88 shtohet neni 88/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 88/1

Transferimi i të drejtave

1. Të drejtat mbi markën mund të transferohen me ose pa transferimin e biznesit të transferuesit.

2. Transferimi i markës mund të mbulojë një, disa ose të gjithë mallrat ose shërbimet për të cilat është bërë kërkesa.

3. Transferimi i markës nuk ka efekt, nëse transferimi nuk shënohet në "Regjistrin e markave."

Neni 11

Në nenin 89 shtohet paragrafi i tretë, me këtë përmbajtje:

"(3) a) Në vijim të masave të specifikuara në paragrafin e dytë pika a të këtij neni, gjykata mund të rivendosë situatën që ekzistonte pas shkeljes dhe të ndalojë veprimet e shkeljes, të procedojë me masa efektive në lidhje me mallrat dhe, kur është e nevojshme të asgjësojë markat e përdorura ilegalisht, mjetet që janë përdorur për prodhimin e mallrave dhe mallrat vetë, në mungesë të mundësisë për të lëvizur markën ilegale nga mallra të tilla.

b) Gjykata për çdo vendim njofton Drejtorinë e Patentave dhe Markave.

Neni 12

Në nenin 92, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"Regjistrimi i markës mund të revokohet nëse pronari i markës së regjistruar e ka përdorur atë për mallrat ose shërbimet, që u referohen regjistrimit, gjatë një periudhe prej 3 vjetësh, pa patur arsye bindëse."

Neni 13

Në nenin 93 shtohet paragrafi i shtatë, me këtë përmbajtje:

“Personat, të cilët nuk janë të autorizuar të përdorin emërtimin e origjinës, nuk mund ta përdorin këtë emërtim edhe në qoftë se ata shtojnë fjalët “tip”, “stil”, “formë”, “prodhuar si” ose fjalë të ngjashme me këto.”

Neni 14

Në nenin 93 shtohet paragrafi i tetë, me këtë përmbajtje:

“Mbrojtja e emërtimeve të origjinës zbatohet kundër treguesve gjeografikë të cilët, megjithëse në kuptimin e drejtpërdrejtë janë të vërtetë përsa i takon territorit, krahinës ose lokalitetit nga kanë origjinën mallrat, në mënyrë të gabuar paraqesin në publik mallra që e kanë origjinën nga një territor tjetër.”

Neni 15

Neni 94 ndryshohet si vijon:

“Drejtoria e Patentave dhe Markave

Drejtoria e Patentave dhe Markave është institucion qendror publik në varësi të Këshillit të Ministrave dhe drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili përfaqëson Drejtorinë në gjykatë dhe institucionet e tjera qendrore.

Struktura e saj miratohet nga Kryeministri.

Veprimtaria e Drejtorisë së Patentave dhe Markave përcaktohet dhe rregullohet me anën e këtij ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Drejtori i Drejtorisë së Patentave dhe Markave emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli i Ministrave.

Për të vulosur patentat, certifikatat e regjistrimit të markave tregtare e të shërbimit, dizenjove industriale dhe dokumente të tjera të përcaktuara në rregullore, Drejtoria e Patentave dhe Markave ka vulën e saj.

Neni 16

Pas nenit 93 shtohet neni 93/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 93/1

Të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi

Çdo person, i cili ka regjistruar një emërtim origjine dhe/ose emri i të cilit ka hyrë si përdorues i emërtimit të origjinës, ka të drejtë ta përdorë atë për përcaktimin e mallrave, që mbulohen nga regjistrimi, ose ta përdorë në reklama a në letrat e biznesit. Ai ka të drejtë të ndalojë përdorimin e emërtimit të origjinës nga persona të tretë, që nuk kanë hyrë si përdorues të tij.”

Neni 17

Neni 97 ndryshohet si vijon:

“Për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve në çështjet e patentave, markave tregtare dhe dizenjove industriale, brenda strukturës së Drejtorisë së Patentave dhe Markave, krijohet Bordi i Apelimit, i cili vepron në përputhje me ligjin.”

Neni 18

Në nenin 100 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Personat fizikë apo juridikë të vendeve jashtë Unionit të Parisit, që kanë rezidencë apo veprimtari, reale dhe efektive, industriale ose tregtare në territorin shqiptar, trajtohen njëlloj si personat fizikë apo juridikë të vendeve të Unionit.”

Neni 19

Në nenin 101 shtohet paragrafi i katërt me këtë përmbajtje:

4. Autoritetet gjyqësore për të mbrojtur të drejtat e pronësisë industriale nga çdo shkelje e mundshme, veçanërisht për të parandaluar futjen në tregti të mallrave të ndryshme, duke përfshirë edhe mallrat e importuara menjëherë pas shlyerjes së detyrimeve doganore, si dhe për të mbrojtur provat dhe të dhënat në lidhje me shkeljen e bërë, me kërkesë të mbajtësit të së drejtës së pronësisë industriale ose të përfaqësuesit të tij, mund të urdhërojnë vendosjen e menjëhershme të këtyre masave provizore:

a) bllokimin e mallrave, të cilat janë mbartëse të të drejtave të pronësisë industriale ose të mjeteve të tjera për prodhimin e këtyre mallrave;

b) mospërdorimin e shpikjes, markës ose të çdo shenje tjetër, që përbën objekt të së drejtës së pronësisë industriale.

Neni 20

Togfjalëshi “Zyra e patentave” kudo ku përmendet në ligj, zëvendësohet me togfjalëshin “Drejtoria e Patentave dhe Markave”.

Neni 21

Nenet 96, 102, 103 dhe 104 të ligjit nr.7819, datë 27.4.1994 “Për pronësinë industriale”, si dhe çdo dispozitë që vjen në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2359, datë 4.5.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani